

Monitorimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
RAPORT VLERËSIMI

Nr. 2

Tetor 2025

Ky Raport Vlerësimi Nr. 2, për Eficiência e Gjykatës dhe Cilësinë e Drejtësisë, është hartuar në kuadër të projektit “Konsolidimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm – një Rishikim i Ndikimit mbi Eficiência e Gjyqësorit dhe Cilësinë e Drejtësisë” i zbatuar nga Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), me mbështetjen e financimit të MATRA program i Mbretërisë së Hollandës, nëpërmjet përfaqësimit të saj në Shqipëri.

Projekti synon të përmirësojë eficiência e performancës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë pranë saj pas shkrirjes së gjashtë gjykatave të apelit në një të vetme, në respektim të legjislacionit të miratuar për këtë qëllim dhe standarteve të cilësisë së drejtësisë.

Foto krediti (kopertina dhe brenda): ©

© ISPL, 2025

Riprodhimi është i autorizuar me kusht që të njihet e drejta e autorit.

ISPL nuk është përgjegjës për përdorimin që mund të bëhet i informacionit të mëposhtëm.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	4
2. AFATET - Përcaktimi i afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve në gjykatë e Apelit	5
3. MONITORIMI - Afatet dhe arsyet e mospërmbushjes së tyre	8
4. ORGANIKA - Plotësimi urgjent i organikës nga KLGJ-ja (31 gjyqtarë nga një organikë prej 78)	9
5. NDIHMËSIT LIGJORË - Krijimi i strukturës me këshilltarë ligjorë edhe rajonalë në ndihmë të ecurisë së gjykimit të çështjeve të prapambetura	11
6. ORGANIZIMI I PROCESIT - Ndryshim ligjor tjetër. Seancat përgatitore në Apel me gjyqtar të vetëm në rastet e juridiksionit fillestar	12
7. PRIORITETI - Shqyrtimi me përparësi i çështjeve/ankimeve ndaj vendimeve të ndërmjetme për pezullimin e gjykimit, “sigurimin e padisë”, vendimet me ekzekutim të përkohshëm.....	13
8. ÇËSHTJET NGA ISH GJYKATAT E APELEVE - Grupimi i çështjeve të mbartura dhe/ose mbledhura nga ish apelet, sipas lëndëve	15
9. MODELE STANDARTE VENDIMESH - drafte të miratuara me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor	16
10. MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE - Sistem menaxhimi çështjesh tërësisht të unifikuar dhe të lehtë në aksesim me mundësi depozitimi digital dhe video	17
11. ZGJIDHJA ALTERNATIVE - e detyruar përpara se palët t’i drejtohen gjykatës	18
12. Bibliografia	20

Hyrje

Ky Raport Vlerësimi është raporti i dytë i hartuar pas monitorimit të realizuar nga ekspertët e projektit për periudhën Prill - Shtator 2025 në gjykatë dhe të raporteve 6-mujore të gjykatës dhe të KLGJ, dhe në vijim të vlerësimit të dobësive të performancës në drejtim të efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Raporti ka në konsideratë këto objektiva specifike:

Të bëjë të njohur gjetjet dhe konkluzionet kryesore të Monitorimit të Performancës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë pranë saj, të përditësuar për periudhën gjashtë mujore Prill-Shtator 2025.

Të gjenerojë ide dhe sugjerime për përmirësimin në vazhdimësi të efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë pranë saj.

2. AFATET- Përcaktimi i afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve në gjykatë e Apelit

Elementi kohë apo afati i shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore ka qenë në fokus të ndryshimeve të vazhdueshme legislative mbështetëse dhe të domosdoshme të funksionimit praktik të Reformës në Drejtësi. Themeli i këtij parimi të rëndësishëm, në vetvete përbën një të drejtë për çdo qytetar, palë apo subjekt të së drejtës, për një proces të rregullt ligjor dhe administrim të mirë të procesit.

Ndryshimet e prezantuara përmes Nenit 399/2 i K.Pr.Civile, sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve civile e penale edhe për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, parashikojnë ndër të tjera sa vijon:

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;

d) në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në gjykimin në apel përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj”.

Duke i qëndruar bindjes tonë se, ndërhyrja e ligjvënësit me këtë kuadër ligjor, në funksion të garantimit të një të drejte të lidhur drejtpërdrejt me procesin e rregullt ligjor, sikundër është gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, ka qenë e domosdoshme, nga ana tjetër ky rregullim ligjor duhet harmonizuar edhe me pjesën organizative të administrimit të dhënies së drejtësisë.

Sikurse është shprehur GJEDNJ¹, është përgjegjësi e shteteve kontraktuese të organizojnë sistemin e tyre gjyqësor, në mënyrë që juridiksionet e tyre mund t’u garantojnë të gjithëve të drejtën për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre civile brenda një periudhe të arsyeshme.

¹ Shih Zouhar kundër Republikës Çeke, 11 tetor 2005, § 37; Comingersoll S.A. kundër Portugalisë [GC], 6 prill 2000, § 24).

Në ushtrim të përgjegjësive të parashikuara në nenin 93 të ligjit nr. 115/2016 “*Per organet e qeverisjes se sistemit te drejtësisë*”, Këshilli i Lartë Gjyqësor² ka shprehur mendime dhe ka bërë propozime lidhur me ndryshimet në legjislacionin, që mund të ndikojë në punën e gjyqësorit dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e Këshillit. Më konkretisht, bazuar në nenin 94/4 të po këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor sa i përket rregullave standarde për eficiencën e drejtësisë sipas të cilave Këshilli bën parashikime për afatet standarde kohore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore, duke mbajtur parasysh organizimin gjyqësor dhe normat procedurale, ka miratuar Vendimin nr. 433, datë 22.07.2025 “*Për përcaktimin e afateve standarte minimale kohore dhe standarteve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve*”.

Sipas këtij vendimi, afatet standarde minimale kohore në seksionin penal në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë si më poshtë:

- a. Kundërvajtjet penale, jo më gjatë se 2 muaj;
- b. Kërkesat penale, jo më gjatë se 3 muaj;
- c. Çështjet penale themeli, jo më gjatë se 6 muaj.

Afatet standarde minimale kohore në seksionin civil në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë si më poshtë:

- a. Kërkesat civile me objekt lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, jo më gjatë se 2 muaj;
- b. Kërkesat civile pa palë kundërshtare, jo më gjatë se 2 muaj;
- c. Çështjet civile me objekt marrëdhënie pune, jo më gjatë se 4 muaj;
- ç. Çështjet familjare, jo më gjatë se 4 muaj;
- d. Çështjet civile dhe tregtare me palë kundërshtare, jo më gjatë se 6 muaj;
- dh. Çështjet civile me palë kundërshtare, të natyrës komplekse, jo më gjatë se 12 muaj.

Standartet minimale sasiore:

² Referuar Vendimit nr. 232, datë 23.04.2025 të KLGJ “*Për miratimin e raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ gjatë vitit 2024*”, në lidhje me Rekomandimin nr. 4 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë: “Të hartojë dhe të miratojë aktet për përcaktimin e standardeve minimale kohore dhe sasiore për gjykimin e çështjeve”, gjatë vitit 2024, Këshilli ka ndërmarrë iniciativën për rishikimin e standardeve minimale kohore dhe sasiore që i përshtaten situatës aktuale të sistemit gjyqësor në Shqipëri, si edhe i përgjigjen rekomandimeve të Progres Raportit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2023. Rishikimi i standardeve ka për qëllim rritjen e efikasitetit të gjykatave duke u bazuar në parimet e mirëqeverisjes, efektivitetit, transparencës dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, si dhe synon vendosjen e standardeve të njëjta për gjyqtarët dhe garantimin e një ngarkese të ekuilibruar të punës në gjykata. Në këtë kuadër, me urdhër të Kryetarit të Këshillit, në vitin 2024 është ngritur një grup pune, i cili është angazhuar në draftimin e akteve përkatëse mbi caktimin e standardeve minimale kohore dhe sasiore për gjykimin e çështjeve dhe hartimin e modeleve standarde të vendimeve gjyqësore. Veprimtaria e grupit të punës pritet të finalizohet brenda marsit të vitit 2025.

Gjyqtari i gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, si relator, gjykon jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare.

Afatet standarde minimale kohore zbatohen vetëm për ato çështje për të cilat ligji nuk parashikon afate gjykimi.

Standardi minimal kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor minimal, nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes. Për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm afati minimal kohor, fillon nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

Standardi minimal sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale përcaktuar në këtë vendim.

Duke vepruar si një ndër aktorët që direkt qeveris sistemin e drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor është treguar i qartë dhe i prërë në orientimet e drejtuara trupave gjyqësore sidomos në një kohë kur megjithë ndryshimet ligjore të miratuara si përmendim më sipër, sërish vonesat janë jashtëzakonisht të gjata dhe të pranishme. Kështu, pavarësisht këtyre masave, në praktikë çështja e afateve mbetet sfiduese për gjyqësorin dhe vetë aktorët e përfshirë në mbështetjen e tij. Madje në një sërë vendimesh, në rastin konkret në vendimin nr. 33/2021, sipas arsyetimeve të dhëna nga ana e Gjykatës Kushtetuese ngrihen dyshime për mundësitë që edhe vetë mjeti përshpejtues ka për t’iu përgjigjur në shkallën e duhur nevojës së të drejtës së individëve për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në raport me mundësitë reale të sistemit gjyqësor, për shkak të vëllimit të lartë të çështjeve, si dhe burimeve njerëzore dhe infrastrukturore të tij në tërësi.

Nëse citojmë vendimin nr. 33/2021, Gjykata Kushtetuese ka vijuar duke u shprehur se: *“...ndonëse i vlerëson masat e mësipërme që janë marrë nga autoritetet përkatëse, të cilat së bashku me mjetin përkatës të përshpejtimin të proceseve të gjykimit i shërbejnë qëllimit të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë gjyqësore, thekson se ky mjet mund të jetë efektiv në rrethana të zakonshme të organizimit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor...”*

Një reformë efektive kërkon zbatim praktik dhe dukshëm ndryshimet ligjore procedurale që lidhen me afatet e arsyeshme nuk po tregojnë se ka një balancim midis shpejtësisë dhe cilësisë të gjykimit në terma praktikë.

Përcaktimi i rregullave për afatet standarde minimale kohore dhe standardet minimale sasiore të gjykimit të çështjeve me qëllim rritjen e efikasitetit të gjykatave nga ana e Këshillit synon

vendosjen e standardeve të njëjta për gjyqtarët dhe ngarkesë të ekuilibruar të punës në gjykata, pa patur force detyruese procedurale. Nga ana tjetër këto rregullime nuk u krijojnë palëve të drejta për të kërkuar përmbushjen e afatit të arsyeshëm apo për të vënë në lëvizje mekanizmat e përshpejtimit të gjykimeve të caktuara.

Duke e parë në këtë këndvështrim çështjen e afateve të shqyrtimit të një çështje në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, mendojmë se është iminente ndërhyrja në ligj edhe për këtë komponent të rëndësishëm, përmes thirrjes së aktorëve që janë të ngarkuar me marrjen e masave efektive si Kuvendi apo edhe Këshilli i Ministrave, të cilët mund të miratojnë afate detyruese ligjore dhe mekanizma kontrolli apo edhe sanksionimi.

3. MONITORIMI - Afatet dhe arsyet e mospërmbushjes së tyre

Krahas parashikimit për afatet standarde minimale kohore dhe standartet minimale sasiore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore të miratuara me Vendimin nr. 433, datë 22.07.2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcaktuar në vendim se me miratimin e këtyre standardeve, kryetarët e gjykatave do të monitorojnë zbatimin e tyre mbi baza 3-mujore dhe do të përcjellin pranë Këshillit raportet përkatëse.

Çështja e monitorimit të afateve ndërthur disa aspekte dhe hapa praktike. Në përputhje me ligjin nr. 98/2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor”* më së pari vetë gjykata është përgjegjëse për menaxhimin e çështjeve dhe sigurimin e shqyrtimit të tyre brenda afateve të arsyeshme. Referuar kuadrit ligjor bazë, gjykata, Këshilli i Lartë Gjyqësor si edhe ILD për sa mund të përfshihet, kanë secili një rol të caktuar në monitorimin konkret të përmbushjes së afateve të arsyeshme të gjykimit. Kryetari i Gjykatës së Apelit është përgjegjës për monitorimin e ecurisë së çështjeve dhe për respektimin e afateve të përcaktuara nga ligji dhe standartet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili nga ana tjetër luan rolin e mbikëqyrjes dhe analizës së të dhënave për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm duke mbledhur dhe përpunuar raportet mujore e tremujore nga kjo gjykatë. Në këtë mënyrë Këshilli evidenton vonesat qoftë ato sporadike qoftë vonesat sistematike dhe mund të propozojë masa për përmirësim.

Por, monitorimi i afateve në vetvete nuk mjafton nëse nuk kuptohen shkaqet (mungesë gjyqtarësh, pushime, kompleksitet, etj.) të cilat e sjellin vonesën në gjykim.

Në këtë kuptim, duke e theksuar edhe se qëllimi në vetvete nuk është *“shkurtimi i afateve”*, konsiderojmë më shumë rëndësi që të identifikohen shkaqet, sidomos ato sistematike, të

vonesave, të çfarëdolloji qofshin këto, vonesa të lidhura me stafin, infrastrukturën, mungesën e gjyqtarëve, kompleksitetin e çështjes, etj. dhe në vijim të ndermerren masa korrigjuese në ndarjen e punës, në rregullore apo qoftë edhe në legjislacion.

Disa nga mënyrat më efikase që do të rekomandonim për të kuptuar arsyet reale të vonesave janë:

- a. të mundësohet që qytetarërt, palët në proces (avokatët, përfaqësuesit ligjorë, palët vetë) të dorëzojnë vëzhgime periodike për vonesat dhe arsyet e perceptuara, përmes një formulari elektronik në faqen e gjykatës (p.sh. “Vëzhgim mbi vonesat e procesit tuaj”), ose një mekanizmi të *feedback*-ut anonim, që analizohet nga Kryetari i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- b. Të përcaktohen rubrika të veçanta në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve për shënime mbi arsyet e vonesave; c. të zbatohet raportim specifik i lidhur vetëm me vonesat që gjykata raporton përmes një formulari unik të përcaktuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, p.sh. çdo 6 – muhor, duke identifikuar shkaqet reale të vonesave, pas kryerje së një analize brenda gjykatës.

4. ORGANIKA - Plotësimi urgjent i organikës nga KLGJ-ja (31 gjyqtarë nga një organikë prej 78).

Referuar Vendimit nr. 232, datë 23.04.2025 të KLGJ “Për miratimin e raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ gjatë vitit 2024”, nga analizimi i *backlog*-ut, rezulton se pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë inventarizuar në total 33.349 dosje (12.255 dosje penale dhe 11.094 dosje civile) 72 duke filluar nga çështjet me regjistrim më të hershëm në gjykatë.

Një ndër rekomandimet e adresuara nga ana e Kuvendit, ai me nr. 5 është që Këshilli të përshpejtojë procesin e plotësimit të vakancave në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”. Bazuar në raportimin nga KLGJ-ja, në përfundim të procedurave të verifikimit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, Këshilli ka ngritur në detyrë 3 gjyqtarë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Po ashtu ka shpallur në vitin 2024, edhe 23 pozicione të lira për ngritje në detyrë pranë kësaj gjykate, për të cilat vijnë procedurat e verifikimit. Në total, së bashku me vakancat e shpallura më herët, Këshilli ka në proces procedurat për plotësimin e 33 pozicioneve të lira të shpallura në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Porse Këshilli i Lartë Gjyqësor ka theksuar se: “...edhe këtë rast duhet theksuar se proceset e ngritjes në detyrë janë të ndërruar edhe nga faktorë të tjerë, siç janë procedurat e vlerësimit etik dhe profesional apo proceset gjyqësore..”

Në rubrikën Njoftime – Vende Vakante në Pushtetin Gjyqësor, në faqen e KLGJ gjejmë të publikuar dokumentin: “Lista e Aplikantëve për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 635-nr. 654 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” e cila përmban një numër prej 41 aplikantësh, por nuk ka informacion mbi sa është numri total i vakancave në fillim të vitit 2025 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sa prej tyre janë plotësuar (emëruar gjyqtarë ose staf) gjatë vitit 2025, dhe cilat janë konkretisht vonesat apo shkaqet e mosplotësimit për vakancat e paplotësuara.

Organika e paplotë dhe problemi i vakancave në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në zgjatjen e afateve të gjykimit dhe në ngarkesën e gjyqtarëve. Konsideruar urgjencën e plotësimit të organikës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm do të rekomandonim transparencë më të mirë në kohë reale, të plotë dhe të aksesueshme publikisht, për ndjekjen e procedurave të shpalljes së vakancave, fazave të përzgjedhjes, ecurisë së vlerësimeve dhe plotësimit të kriterëve ose arsyëve të mosplotësimit, marrjen në konsideratë të rishpërndarjes së përkohshme të gjyqtarëve nga gjykatat e tjera ose ato ish lokale (p.sh. gjyqtarët e spikatur në cilësinë e vendimeve që kanë dhënë), komandimeve të gjyqtarëve si edhe përsheptimin e procedurës së ngritjes në detyrë për kandidatë të vlerësuar “shumë mirë”. Madje aty ku është e mundur mund të ruhen emerimet nga gjyqtarë të ish apeleve të cilët sjellin eksperiencën dhe qëndrueshmërinë e vendimeve cilësore dhe të shpejta në kohë.

5. NDIHMËSIT LIGJORË - Krijimi i strukturës me këshilltarë ligjorë edhe rajonalë në ndihmë të ecurisë së gjykimit të çështjeve të prapambetura

Mirëorganizimi i punës për shqyrtimin e çdo çështjeje civile apo penale, do të krijonte paraprakisht një bazë të shëndoshë për një gjykim më të shpejtë në Gjykatën e Apelit sepse më shumë kapacitet për kërkime juridike, përpunim dosjesh dhe draftim, do të ulte kohën e arsytimit/vendimmarrjes.

Me Vendimin nr. 204 datë 10.04.2025, KLGJ-ja miratoi Rregulloren “Mbi organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Shërbimit Ligjor”, e cila përfshin në rregullimin e saj ndihmësit ligjorë si strukturë mbështetëse gjyqësore. Kjo rregullore formalizon rolin, organizimin dhe

funksionet që ndihmësit ligjorë duhet të kryejnë brenda gjykatave, për t'u siguruar që shërbimi ligjor të funksionojë në mënyrë standarde dhe të mirërregulluar.

Duke e theksuar rolin e rëndësishëm dhe kontributin e projektit “*Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura dhe rritja e efikasitetit të gjykatave*” i zbatuar nga EWMI/INL, për krijimin e ekipit të NUNÇP³ pranë Gjykatave të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Administrativ, e gjejmë mjaft me vend faktin që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vënë në dukje edhe rëndësinë e koordinimit me institucionet e tjera të pavarura, ministritë e linjës apo agjenci qeveritare apo në tërësi me bashkëpunëtorët e sistemit të drejtësisë për të diskutuar problemet e përbashkëta dhe për të konsoliduar bashkëpunimin.

Duke iu përmbajtur parashikimit të vetë Rregullores “*Mbi organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor*” do të rekomandonim transparencë dhe akses publik në kohë reale në mbledhjet periodike që Kryetari i gjykatës organizon, të paktën 1 (një) herë në muaj, me Njësine e Shërbimit Ligjor, për diskutimin e rezultateve të arritura, identifikimin e problematikave të hasura dhe mënyrat për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre, me qëllim mbarëvajtjen e gjykatës.

Gjithashtu, do të rekomandonim që në strukturat e Njesisë së Shërbimit Ligjor të funksionojnë edhe këshilltarë “*rajonale*” apo ish-gjyqtarë të cilët mund të sjellin përvojën e pozicioneve të mëparshme në ish gjykatat e apeleve në vend dhe mund të merren me çështje me kompleksitet më të madh të cilat ndihmësit ligjorë nuk mund t'i përballojnë vetëm. Duke vepruar në rol këshillues, ata mund të jenë në gjendje edhe për të kryer një rol koordinues me fokusin e caktimit të afateve dhe normave në ecurinë e shqyrtimit të çështjeve kraha plotësimi të organikës së gjykatës, p.sh. brenda 3 viteve norma e çështjeve mund të ketë një ecuri në përqindje nga 25% në 50% ose më shumë, e parë në çdo rast në paralele me plotësimin e organikës së plotë të gjykatës.

³ Nga të dhënat statistikore të marra nga KLGJ-ja, rezulton se ekipi i NUNÇP-ve pranë Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka përpunuar 1146 dosje gjyqësore (639 civile dhe 507 penale), nga të cilat janë gjykuar dhe dhënë vendime nga trupat gjyqësore, në total për 257 çështje (151 civile dhe 106 penale).

6. ORGANIZIMI I PROCESIT - Ndryshim ligjor tjetër. Seancat përgatitore në Apel me gjyqtar të vetëm në rastet e juridiksionit fillestar

Norma e ligjit procedural është se Gjykata e Apelit gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Efikasiteti procedural (po ashtu edhe proporcionaliteti), është detyrim pozitiv i shtetit, që rrjedh nga kërkesa e nenit 6 të KEDNJ për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe që në këtë aspekt nënkupton që gjykatat duhet të organizojnë strukturën e tyre në mënyrë që të shmangin vonesat e panevojshme, të përdorin burimet njerëzore në mënyrë optimale dhe të sigurojnë që çdo gjykim të jetë funksional dhe i shpejtë. Në harmoni me këtë parim, sipas neneve 21 deri 24 të ligjit nr. 98/2016, “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor*” vërejmë se lejohet rregullimi i brendshëm i përbërjes së trupave gjyqësore sipas natyrës së çështjes.

Rrjedhimisht, procedurat dhe mjetet procedurale që përdor gjykata duhet të jenë të mjaftueshme dhe të arsyeshme në raport me qëllimin që synohet, pra zgjidhja e çështjes, garantimi i të drejtave të palëve dhe shmangia e vonesave.

Veçanërisht në këtë fazë të vlerësimit praktik mbi eficiencën e Gjykatës së Apelit, nisur edhe nga diskutimet e zhvilluara në takimet me Avokaturën e Shtetit, do të rekomandim që të merrej në konsideratë ndryshimi ligjor sipas të cilit të parashikohej se në rastet kur Gjykata e Apelit vepron me juridiksion fillestar, të gjykojë me një gjyqtar të vetëm në seancat përgatitore. Jemi të mendimit se vendimmarrja paraprake e një gjyqtari nuk cenon të drejtën e palëve, për sa kohë që vendimi final jepet nga trupi kolegjial, dhe përkundrazi, kjo rrit efikasitetin procedural dhe ul ngarkesën në Apel, duke i afruar madje kështu gjykatat shqiptare edhe me praktikat evropiane.

Ky rekomandim vlen vetëm në fazën përgatitore të gjykimeve fillestare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kur kjo gjykatë ushtron juridiksionin fillestar, pra kryesisht për verifikimin e kushteve paraprake të padisë ose akuzës, kryerjen e veprimeve përgatitore, pranimin ose refuzimin e provave, shqyrtimin e kërkesave procedurale, apo caktimin e datës së seancës gjyqësore të themelit.

Duke qenë se shpesh ndodh që seancat përgatitore vonohen ose shtyhen për shkak të mungesës së trupave kolegjiale, përdorimi i një gjyqtari të vetëm për këtë fazë ul kohëzgjatjen e proceseve dhe përmirëson raportin ndërmjet çështjeve të regjistruara dhe atyre të përfunduara.

7. PRIORITETI - Shqyrtimi me përparësi i çështjeve/ankimeve ndaj vendimeve të ndërmjetme për pezullimin e gjykimit, “sigurimin e padisë”, vendimet me ekzekutim të përkohshëm

Sipas perceptimeve të ndara me Avokaturën e Shtetit, gjykatat, po shkelin çdo afat të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile dhe në ligjin e gjykimeve administrative, i cili kur u miratua kishte qëllim dhe shqyrtimin e çështjes brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.

Në raste të shpeshta në praktikën gjyqësore po konstatohet shtim i rasteve në të cilat kryesisht gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, përmes vendimeve të ndërmjetme për pezullimin e gjykimit, të zgjatura në kohë po sjellin si pasojë shkeljen e afatit të arsyeshëm.

Një shqetësim dhe problematikë, janë çështjet me objekt ankimin ndaj vendimeve të ndërmjetme të dhëna nga gjykata ose ato me objekt “*sigurimin e padisë*”, ku rezulton se vendimmarrja zvarritet përtej urgjencës që kërkon natyra e tyre, duke zhvlerësuar efektin e masës dhe duke rrezikuar dëme të pariparueshme eventualisht edhe për shtetin⁴.

Kodi i Procedurave Civile, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të parë e në apel nga fillimi i tij në secilën shkallë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së) dhe afatin 2- vjeçar për kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit të çështjeve civile nga Gjykata e Lartë (neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së), i cili gjen zbatim edhe në shqyrtimin e çështjeve administrative.

Jurisprudenca e GJEDNJ dhe Gjykatës Kushtetuese ka përcaktuar me qartësi kriteret për vlerësimin e këtij afati që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuarit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuari, ku lidhur me sjelljen e autoriteteve theksohet se neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së kërkojnë që procedurat gjyqësore të jenë të shpejta, duke vënë theksin në parimin e përgjithshëm të administrimit të duhur të drejtësisë.

⁴ Në shumë raste, vendimi i marrjes së masave të sigurimit në favor të palëve të treta, ka çuar në pezullimet e ekzekutimit të akteve administrative, që janë projekte dhe punë publike, apo pengesa në përmbushje të qëllimeve madhore të një enti/ organi publik, pasi marrja e kësaj masë sigurimi është bërë tashmë një instrument që praktikisht bllokoi aktivitetin normal të institucioneve shtetërore. Shqyrtimi i masës së sigurimit në apel, ndonëse herë pas here bëhet “*Kërkesë për përsheptim*”, sjellja dhe qëndrimi i gjykatave, është e paparashikueshme, pasi mund të kalojnë muaj dhe vite deri sa masa e sigurimit të shqyrtohet nga gjykatat e apelit civil apo administrativ.

Në praktikën gjyqësore tashmë janë evidentuar raste të shumta kur vonesat e pajustificuara kanë sjellë jo vetëm konstatimin e shkeljes së të drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, por edhe hapjen e proceseve të reja gjyqësore ku kërkohet dëmshpërblim financiar nga individët apo subjektet e prekura nga këto vonesa. Këto raste rëndojnë sistemin gjyqësor me çështje shtesë dhe vendosin në pozitë të vështirë edhe palët edhe organet shtetërore të përfaqësimit ligjor.

Madje në vijim të këtij argumenti, ka shumë raste kur Gjykatat e Apelit nuk kanë marrë në shqyrtim çështjet edhe kur janë detyruar me vendimmarrje nga Gjykata Kushtetuese, për shqyrtimin e çështjes brenda afateve të përcaktuara nga kjo e fundit.

Për më tepër, pasojat nuk kufizohen vetëm në kuadrin e brendshëm, por zvarritjet procedurale dhe shkeljet e afatit të arsyeshëm, janë kthyer në objekt shqyrtimi edhe në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila tërheq vëmendje Shtetit Shqiptar.

Nëse nuk arrihet të garantohet që ankimet ndaj vendimeve të ndërmjetme, të cilat kanë efekt të menjëhershëm mbi të drejtat materiale ose mbi ecurinë e procesit gjyqësor, të shqyrtohen me përparësi nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, situata ku do të gjendemi do të përbëjë shkelje këtë herë nga ana e gjykatës të parimevë të efikasitetit procedural dhe garantimit të mbrojtjes efektive gjyqësore (neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 42 i Kushtetutës)⁵.

Vonesa në shqyrtimin e ankimeve për këto vendime mund të bëjë të pavlefshme vetë qëllimin e mbrojtjes së përkohshme përveçse të çënojë barazinë e palëve në proces dhe të passjellë pasoja të parikthyeshme ekonomike apo të tjera.

Në këtë kuptim, shqyrtimi me përparësi i këtyre ankimeve përbën një element kyç të realizimit të parimit të proporcionalitetit procedural.

Rekomandimet në këtë drejtim përfshijnë:

- a. Marren e masave nga ana e Kryetarit të Gjykatës që ankimet ndaj vendimeve për sigurimin e padisë, pezullimin e gjykimit dhe ekzekutimin e përkohshëm të regjistrohen dhe caktohen për shqyrtim brenda një afati maksimal prej 15 ditësh nga data e depozitimit të ankimit;

⁵ Në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (çështjet *Micallef kundër Maltës*, *Scordino kundër Italisë*, *Pretto kundër Italisë*), është theksuar se efikasiteti procedural kërkon që mjetet juridike kundër vendimeve të përkohshme të kenë rishikim të shpejtë dhe efektiv, në mënyrë që të mos shndërrohen në mjete iluzive.

- b. Sistemi ICMIS të shënojë automatikisht këto lloje çështjesh me shenjë "URGJENTE";
- c. Ndhmësit ligjorë dhe këshilltarët rajonalë të përgatisin për çdo çështje: (i) analizë paraprake për proporcionalitetin e masës së vendosur nga gjykata e shkallës së parë; (ii) përmbledhje të praktikës gjyqësore dhe jurisprudencës përkatëse; (iii) draft-raport për ndihmën e trupit gjykues në marrjen e vendimit të shpejtë;
- d. Gjykatat e Apelit dhe ajo e Lartë të respektojnë vendimmarrjen dhe afatet e lëna për gjykim nga Gjykatës Kushtetuese, sa i takon shqyrtimit të çështjeve apo shkeljeve të konstatuara.
- e.

8. ÇËSHTJET NGA ISH GJYKATAT E APELEVE - Grupimi i çështjeve të mbartura dhe/ose mbledhura nga ish apelet, sipas lëndëve

Ndërsa me miratimin e Udhëzimit "*Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykata*"⁶, Këshilli ka vendosur rregulla të qarta për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe atyre që regjistrohen rishtazi sipas llojit dhe natyrës së tyre, në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ, jemi të mendimit se identifikimi dhe grupimi i dosjeve të ardhura nga ish gjykatat e apeleve në rrethe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë është një veprim që ndihmon jo vetëm ngarkesën e punës në këtë gjykatë por edhe qartësimin e aktorëve të përfshirë në ofrimin e ndihmesës në rritjen e efikasitetit të gjykatës, përmes transparencës dhe qartësisë së ecursit të shqyrtimit të ankimeve.

Dosjet që kanë arritur në faza më të avancuara të shqyrtimit (p.sh. janë në seanca gjyqësore, apo kanë afate për vendim) rekomandojmë se duhet të trajtohen me prioritet dhe se duhen shpërndarë në seksione gjykimi që kanë kapacitet për përfundim të shpejtë. Në këtë kuadër kriteret apo ndarjet ose grupimet e këtyre dosjeve mund të jenë sipas rasteve "*dosje në seanca përgatitore*" / "*dosje në seanca gjyqësore*" / "*dosje në tejkalim të afateve standarte të gjykimit*" / "*dosje me karakter urgjent*".

⁶ Identifikimi i çështjeve më të vjetra dhe atyre në numër më të lartë, shërben për të zbatuar më pas masat konkrete për evadimin e tyre, bazuar në parimet e gjykimit me përparësi të çështjeve të natyrës urgjente, renditjes kronologjike të tyre, si edhe nivelit të kompleksitetit. Për zbatimin e këtij akti, pranë gjykatave të apelit janë krijuar grupet e punës për inventarizimin e dosjeve, të cilët kanë analizuar dhe klasifikuar çështjet gjyqësore duke marrë në konsideratë radhën kronologjike të regjistrimit të tyre. Nga analizimi i backlog-ut, rezulton se pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë inventarizuar në total 33.349 dosje (12.255 dosje penale dhe 11.094 dosje civile) duke filluar nga çështjet me regjistrim më të hershëm në gjykatë.

Kjo mënyre grupimi ndikon rrjedhimisht më tej në shpërndarjen e ngarkesës për gjyqtar, duke marrë në konsideratë edhe ngarkesën aktuale të tyre edhe kompleksitetin apo volumin e punës që përmban dojsa përkatëse.

9. MODELE STANDARTE VENDIMESH - drafte te miratuara me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Çështja e gjuhës së përdorur dhe volumit të një vendimi Gjyqësor është ngritur edhe në Raportin e parë të vlerësimit, si e lidhur drejtpërdrejt me drejtën e aksesit në një gjykim, e mbi të gjitha, të drejtën për një proces të rregullt ligjor, si një prioritet më vete i cili përbën premisë për ndërhyrje në ligjet procedurale civile, duke tentuar që të reduktojë:

- a) Vendimet gjyqësore voluminozë, arsyetimi i të cilëve kërkon patjetër një kohë shumë të gjatë fizike në konceptim dhe shkrim;
- b) Komplexitetin e termave të përdorur në vendimet gjyqësore, duke shkuar më tepër në drejtim të një gjuhe më të thjeshtë, më të qartë për çdo palë në proces apo, për cilindo që ka një interes të ligjshëm rreth vendimmarrjes;
- c) Kohën e arsyetimit të një vendimi, në funksion të shpejtësisë së dhënies së drejtësisë;

Duke iu referuar sa sipër, mendojmë se është e udhës që të ndërhyet në ligjet procedurale, për të kornizuar çështjen e arsyetimit të kuptueshëm të një vendimi gjyqësor. Duke evituar stërzgjatjen apo karakterin voluminoz të një vendimi gjyqësor, automatikisht reduktohet edhe koha e nevojshme që do të impenjonte shpenzimi i energjive për diçka të tillë, e cila ndryshe do të përkthehej si shpejtësi gjykimi. Në vlerësimin tonë, kjo çështje është dhe duhet të jetë objekt debati, jo thjesht doktrinal por për Magjistratët, të cilët janë investuar në dhënien e drejtësisë në Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Me Vendimin nr. 434, datë 22.07.2025 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar disa modele standart të vendimeve gjyqësore për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (dhe gjykatat e shkallës së parë gjithashtu). Këto modele janë të ndara sipas natyrës së çështjes dhe objektit të saj procedural, dhe shërbejnë për unifikimin e formës dhe arsyetimit të vendimeve në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe të apelit. Në tërësi modelet standarte përfshijnë si vendime përfundimtare (si ato për paditë me vlerë të vogël) edhe vendime ndërmjetëse (pezullim gjykimi, kthim aktesh) ose ekzekutive (urdhër ekzekutimi mbi titujt ekzekutivë), duke shkuar edhe më tej në dhënien e modeleve për vendimet për çështje civile, tregtare dhe procedurale, duke standardizuar format e vendimeve për qëllimin e gjykimit të shpejtë dhe

efikas të çështjeve të vogla dhe vendime të natyrës procedurale-administrative që lidhen me ecurinë e procesit.

Në të njëjtën linjë dhe logjikë të modelimit të vendimeve për disa çështje të caktuara do të sugjerohet të përfshiheshin edhe vendimet për çështjet e natyrës familjare, të marrëdhënieve të punës, të të drejtave të përfitimit të pensionit e të sigurimeve shoqërore, të cilat kategorizohen në çështjet e natyrë prioritarë apo për shqyrtim me procedurë të përsheptuar në Gjykatën e Apelit.

Përfshirjen e këtyre vendimeve model për këtë natyrë çështjesh, e konsiderojmë si një nga zgjerimet më logjike dhe të nevojshme të vendimeve model sipas Vendimit nr. 434, datë 22.07.2025 të KLGJ-së, i cili aktualisht mbulon më së shumti çështje civile, tregtare dhe procedurale, por jo në mënyrë të plotë çështjet familjare, të punës dhe të pensioneve.

10. MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE - Sistem menaxhimi çështjesh tërësisht të unifikuar dhe të lehtë në aksesim me mundësi depozitimi digital dhe video

Lidhur me Rekomandimin nr. 8 të Kuvendit: *“Të ndërmarrë angazhime konkrete për sa i takon Këshillit bazuar në kompetencat e tij ligjore dhe të përmbyllë në një kohë sa më të shkurtër ngritjen dhe bërjen funksional të sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore për të përmbushur detyrimin ligjor, si dhe të njoftojë periodikisht Kuvendin për ecurinë dhe problematikat”*, nga ana e KLGJ-së është raportuar se QTI ka miratuar të gjithë dokumentacionin teknik të nevojshëm⁷.

Me miratimin e buxhetit të vitit 2025 për sistemin gjyqësor, janë përfshirë fondet për projektin e ri të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), një iniciativë me kohëzgjatje pesëvjeçare, për zbatimin e projektit të ri të ICMIS i cili ka filluar në shkurt 2025, me një buxhet të planifikuar në total prej 1,268,750 mijë lekë (me TVSH).

⁷ Me miratimin e buxhetit për sistemin gjyqësor për vitin 2025, përfshihen fondet për projektin e ri të sistemit ICMIS si dhe marrëveshjen e grantit midis Suedisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Duhet theksuar se projekti ICMIS përfshin 5 vite buxhetore. Kësti i parë i grantit të qeverisë suedeze u disbursua në dhjetor 2024, duke shënuar fillimin e punës për ngritjen e sistemit të ri dhe nisjen e zbatimit të tij në janar 2025. Këshilli disponon të gjitha kapacitetet profesionale të nevojshme, përfshirë njohuritë dhe burimet njerëzore, për të garantuar funksionimin e sistemit ICMIS. Zbatimi i tij do të kontribuojë ndjeshëm në rritjen e efikasitetit të gjyqësorit, duke mundësuar shërbime më të shpejta dhe më cilësore për qytetarët shqiptarë, si dhe duke rritur aksesin në drejtësi.

Në fakt mundojnë të dhëna teknike të detajuara të publikuara sipas të cilave të mund të kuptohet më shumë mbi fazat e projektit dhe hapat konkretë drejt një sistemi të vetëm të unifikuar dhe dixhital, e megjithatë në formën e rekomandimeve mund të shprehemi si vijon:

- a. Të zhvillohen takime dhe prezantime me aktorët dhe grupet e interesit që janë faktorë në harmonizimin dhe integrimin e një sistemi të unifikuar (përfshirë palë dhe avokatë) për t'u njohur me përmbledhje të projektit aktual, masat e rekomanduara për dixhitalizim dhe efektet e pritshme për efikasitetin;
- b. Të sigurohet publikimi i përmbledhur i çdo veprimi dhe hapi të kryer për qëllime transparence;
- c. Të sigurohet ruajtja e integritetit dhe ndërveprimit midis ICMIS dhe ARKIT në mënyrë që arkivimi të bëhet automatik dhe të ruhet në disa vendndodhje me kopje dixhitale;
- d. Të njoftohet apo sinjalizohen palët në sistemin e integruar ICMIS që dokumentat e dosjes tashmë ruhen të arkivuara.

11. ZGJIDHJA ALTERNATIVE - e detyruar përpara se palët t'i drejtohen gjykatës

Tashmë është fakt i publikuar nga ana e KLGJ-se gjithashtu se përdorimi i mekanizmave alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (si ndërmjetësimi apo arbitrazhi) mbetet i kufizuar, duke shkaktuar mbingarkesë çështjesh në sistemin gjyqësor.

Në Kodin e Procedurës Civile është parashikuar se:

“Është detyrë e gjykatës që të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje dhe/ose të njoftojë e të udhëzojë palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim”.

Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjes i referohet metodave të ndryshme të zgjidhjes jashtë proceseve gjyqësore tradicionale. Këto metoda përfshijnë ndërmjetësimin, arbitrazhin dhe në disa raste edhe negocimin, duke ofruar rrugë më fleksibël, më pak kundërshtare dhe më të shpejta drejt zgjidhjes në krahasim me çështjet gjyqësore. Kjo mënyrë thekson zgjidhjen e problemeve në bashkëpunim, duke i lejuar palët e përfshira të mbajnë më shumë kontroll mbi rezultatin.

Një nga avantazhet thelbësore të zgjidhjes alternative është se ajo mund të përshtatet me nevojat specifike të palëve. Gjykatat, në të kundërt, ofrojnë një mjedis të ngurtë, formal me një rezultat të pritshëm - njëra palë fiton dhe tjetra humbet. Arbitrazhi ose ndërmjetësimi në

ndryshim, ofron një platformë për zgjidhje kreative, duke përfshirë zgjidhje që nuk janë të disponueshme në gjykatë, shpesh duke rezultuar në zgjidhje që përfitojnë të dyja palët dhe ruajnë marrëdhëniet.

Së pari: Mendojmë së duhet të shtohet në Kodin e Procedurës Civile parashikimi i cili qartëson kompetencat e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të urdhëruar Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve si përpjekje e pare për palët, përpara se çështja të shqyrtohet nga gjykata, në disa raste të caktuara, si për shembull për çështje të natyrës tregtare midis palëve në një marrëdhënie tregtare afatgjatë (p.sh. *franchising*) e cila është komplekse dhe për të cilën gjykata vlerëson se mund të zgjidhet më mirë dhe me më pak kosto e më shpejt në kohë nëpërmjet zgjidhjes alternative, ose për çështje sensitive familjare të cilat duhet të zgjidhen shpejt me qëllim për të stabilizuar eventualisht marrëdhënien midis palëve.

Së dyti: Gjithashtu, mendojmë se vlen të parashikohet në Kodin e Procedurës Civile edhe rregullimi sipas të cilit orientimi i palëve drejt zgjidhjeve alternative duhet të jetë real, substancial dhe jo thjesht formal në përmbushje të detyrimeve formale të gjykatës. Kështu mund të parashikohet në një propozim për ndryshime ligjore se përpara paraqitjes së padisë, palët që kanë mosmarrëveshje civile, tregtare apo të punës janë të detyruara të provojnë se kanë ndjekur procedurën e ndërmjetësimit ose, sipas rastit, të arbitrazhit, përpara se të drejtohen në gjykatë, duke paraqitur edhe vërtetimin e ndërmjetësimit ose të qendrës së ndërmjetësimit për përfundimin e procesit të ndërmjetësimit, ose vërtetimin e refuzimit të palës tjetër për të marrë pjesë në të. Në mungesë të këtij vërtetimi, gjykata, me vendim të arsyetuar, pezullon shqyrtimin e çështjes dhe i jep palës paditëse një afat 30-ditor për të plotësuar detyrimin.

Tabela 1

(Raporti i Tremujorit II i Viti 2025)

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme ⁸	Nr. çështjeve të regjistruara të reja(nga data 01 janar) ⁹	Nr. çështjeve të gjykuara ¹⁰	Nr. Çështjeve në shqyrtim ¹¹
1.	Iliba Bezati	1885	239	296	1791
2.	Fatri Islamaj	1021	318	243	1105
3.	Edlira Petri	1179	312	200	1202
4.	Genti Shala	1145	299	174	1231
5.	Astrit Kalaja	1932	279	248	1616
6.	Elona Toro	1955	264	203	1669
7.	Arta Duka	1961	271	174	1645
8.	Alma Ahmeti	1885	280	160	1642
9.	Marsela Dervishi	1877	271	259	1637
10.	Ornela Naqellari	1926	255	226	1662
11.	Irida Kacerja	1930	275	192	1660
12	Elona Mihali	1955	268	169	1646
13	Lutfije Celami	1087	249	120	1215
14	Dritan Hasani	1063	310	205	1143
15	Fuat Vjerdha	1042	75	41	949
16	Genti Dokollari	1042	323	262	1104
17	Valdete Hoxha	519	293	160	1167
18	Irena Brahimi	1178	325	212	1241
19	Miranda Andoni	1237	335	212	1244
20	Sokol Pina	1957	250	206	1664
21	Valbona Vata	1951	261	206	1650
22	Alma Kolgjoka	1933	272	215	1640
23	Qemal Zaimi	1160	288	184	1177
24	Marsela Pepi	1172	306	236	1141
25	Brikena Ukperaj	1073	302	193	1138
26	Diamela Goxha	987	263	140	1544
27	Enkela Vlora	1823	229	149	1681
28	Anila Karanxha	1825	265	216	1648
29	Esmerilda Habili	0	130	74	1553
30	Gilda Hoxha	0	135	48	1556
31	Ardit Mustafaj	0	185	58	1185
	TOTALI	41700	8127	5681	44146

⁸ Kjo e dhënë kërkohet vetëm në raportimin e parë tremujor të çdo viti.⁹ Numri aktual i çështjeve të reja të regjistruara që nga fillimi i vitit, (jo vetëm për tremujorin raportues)¹⁰ Çështje të gjykuara që nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit (jo vetëm për tremujorin e raportimit)¹¹ Numri i çështjeve në shqyrtim në momentin e raportimit

BIBLOGRAFIA

1. Vendim GJEDNJ Zouhar kundër Republikës Çeke, 11 tetor 2005, § 37; Comingersoll S.A. kundër Portugalisë [GC], 6 prill 2000, § 24);
2. Ligj nr. 115/2016 “*Per organet e qeverisjes se sistemit te drejtësisë*”;
3. Vendim Nr. 433, datë 22.07.2025 i KLGJ “*Për përcaktimin e afateve standarte minimale kohore dhe standarteve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve*”;
4. Vendim nr. 232, datë 23.04.2025 i KLGJ “*Për miratimin e raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ gjatë vitit 2024*”;
5. Vendim Nr. 33/2021 i Gjykatës Kushtetuese;
6. Ligj nr. 98/2016 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor*”;
7. Vendim nr. 204 datë 10.04.2025, i KLGJ Rregullore “*Mbi organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Shërbimit Ligjor*”;
8. Udhëzim “*Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykata*”;
9. Vendimin nr. 434, datë 22.07.2025 Këshilli i Lartë Gjyqësor;
10. Raportim tremujorit II-te 2025 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ;
11. Kodi i Procedurës Civile;

REKOMANDIME

2. AFATET - Përcaktimi i afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve në gjykatë e Apelit

Rekomandim: është iminente ndërhyrja në ligj edhe për këtë komponent të rëndësishëm, përmes thirrjes së aktorëve që janë të ngarkuar me marrjen e masave efektive si Kuvendi apo edhe Këshilli i Ministrave, të cilët mund të miratojnë afate detyruese ligjore dhe mekanizma kontrolli apo edhe sanksionimi.

3. MONITORIMI - Afatet dhe arsyet e mospërmbushjes së tyre

Rekomandime:

- a. të mundësohet që qytetarërt, palët në proces (avokatët, përfaqësuesit ligjorë, palët vetë) të dorëzojnë vëzhgime periodike për vonesat dhe arsyet e perceptuara, përmes një formulari elektronik në faqen e gjykatës (p.sh. “Vëzhgim mbi vonesat e procesit tuaj”), ose një mekanizmi të *feedback*-ut anonim, që analizohet nga Kryetari i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- b. Të përcaktohen rubrika të veçanta në sistemin elektronik të mënaxhimit të çështjeve për shënime mbi arsyet e vonesave; c. të zbatohet raportim specifik i lidhur vetëm me vonesat që gjykata raporton përmes një formulari unik të përcaktuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, p.sh. çdo 6 – muaj, duke identifikuar shkaqet reale të vonesave, pas kryerje së një analize brenda gjykatës.

4. ORGANIKA - Plotësimi urgjent i organikës nga KLGJ-ja (31 gjyqtarë nga një organikë prej 78).

Rekomandim: Konsideruar urgjencën e plotësimit të organikës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm do të rekomandonim transparencë më të mirë në kohë reale, të plotë dhe të aksesueshme publikisht, për ndjekjen e procedurave të shpalljes së vakancave, fazave të përzgjedhjes, ecures së vlerësimeve dhe plotësimit të kriterëve ose arsyëve të mosplotësimit, marrjen në konsideratë të rishpërndarjes së përkohshme të gjyqtarëve nga gjykatat e tjera ose ato ish lokale (p.sh. gjyqtarët e spikatur në cilësinë e vendimeve që kanë dhënë), komandimeve të gjyqtarëve si edhe përshpejtimin e procedurës së ngritjes në detyrë për kandidatë të vlerësuar “shumë mirë”. Madje aty ku është e mundur mund të ruhen emerimet nga gjyqtarë të ish apeleve të cilët sjellin eksperiencën dhe qëndrueshmërinë e vendimeve cilësore dhe të shpejta në kohë.

5. NDIHMËSIT LIGJORË - Krijimi i strukturës me këshilltarë ligjorë edhe rajonalë në ndihmë të ecures së gjyqimit të çështjeve të prapambetura

Rekomandim 1: transparencë dhe akses publik në kohë reale në mbledhjet periodike që Kryetari i gjykatës organizon, të paktën 1 (një) herë në muaj, me Njësinë e Shërbimit Ligjor, për diskutimin e rezultateve të arritura, identifikimin e problematikave të hasura dhe mënyrat për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre, me qëllim mbarëvajtjen e gjykatës.

Rekomandim 2: në strukturat e Njesisë së Shërbimit Ligjor të funksionojnë edhe këshilltarë “*rajonalë*” apo ish-gjyqtarë të cilët mund të sjellin përvojën e pozicioneve të mëparshme në ish gjykatat e apeleve në vend dhe mund të merren me çështje me kompleksitet më të madh të cilat ndihmësit ligjorë nuk mund t’i përballojnë vetëm. Duke vepruar në rol këshillues, ata mund të jenë në gjendje edhe për të kryer një rol koordinues me fokusin e caktimit të afateve dhe normave në ecurinë e shqyrtimit të çështjeve kraha plotësimit të organikës së gjykatës, p.sh. brenda 3 viteve norma e çështjeve mund të ketë një ecure në përqindje nga 25% në 50% ose më shumë, e parë në çdo rast në paralele me plotësimin e organikës së plotë të gjykatës.

6. ORGANIZIMI I PROCESIT - Ndryshim ligjor tjetër. Seancat përgatitore në Apel me gjyqtar të vetëm në rastet e juridiksionit fillestar

Rekomandim: të merret në konsideratë ndryshimi ligjor sipas të cilit të parashikohej se në rastet kur Gjykata e Apelit vepron me juridiksion fillestar, të gjykojë me një gjyqtar të vetëm në seancat përgatitore. Jemi të mendimit se vendimmarrja paraprake e një gjyqtari nuk cenon të drejtën e palëve, për sa kohë që vendimi final jepet nga trupi kolegjal, dhe përkundrazi, kjo rrit efikasitetin procedural dhe ul ngarkesën në Apel, duke i afuar madje kështu gjykatat shqiptare edhe me praktikat evropiane.

Ky rekomandim vlen vetëm në fazën përgatitore të gjykimeve fillestare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kur kjo gjykatë ushtron juridiksionin fillestar.

7. PRIORITETI - Shqyrtimi me përparësi i çështjeve/ankimeve ndaj vendimeve të ndërmjetme për pezullimin e gjyqimit, “sigurimin e padisë”, vendimet me ekzekutim të përkohshëm

Rekomandime:

- f. Marren e masave nga ana e Kryetarit të Gjykatës që ankimet ndaj vendimeve për sigurimin e padisë, pezullimin e gjyqimit dhe ekzekutimin e përkohshëm të regjistrohen dhe caktohen për shqyrtim brenda një afati maksimal prej 15 ditësh nga data e depozitimit të ankimit;
- g. Sistemi ICMIS të shënojë automatikisht këto lloje çështjesh me shenjën “URGJENTE”;

- h. Ndhmësit ligjorë dhe këshilltarët rajonalë të përgatisin për çdo çështje: (i) analizë paraprake për proporcionalitetin e masës së vendosur nga gjykata e shkallës së parë; (ii) përmbledhje të praktikës gjyqësore dhe jurisprudencës përkatëse; (iii) draft-raport për ndihmën e trupit gjykues në marrjen e vendimit të shpejtë;
- i. Gjykatat e Apelit dhe ajo e Lartë të respektojnë vendimmarrjen dhe afatet e lëna për gjykim nga Gjykatës Kushtetuese, sa i takon shqyrtimit të çështjeve apo shkeljeve të konstatuara.

8. ÇËSHTJET NGA ISH GJYKATAT E APELEVE - Grupimi i çështjeve të mbartura dhe/ose mbledhura nga ish apelet, sipas lëndëve

Rekomandim: Dosjet që kanë arritur në faza më të avancuara të shqyrtimit (p.sh. janë në seanca gjyqësore, apo kanë afate për vendim) rekomandojmë se duhet të trajtohen me prioritet dhe se duhen shpërndarë në seksione gjykimi që kanë kapacitet për përfundim të shpejtë. Në këtë kuadër kriteret apo ndarjet ose grupimet e këtyre dosjeve mund të jenë sipas rasteve *“dosje në seanca përgatitore” / “dosje në seanca gjyqësore” / “dosje në tejkalim të afateve standarte të gjykimit” / “dosje me karakter urgjent”*.

Kjo mënyre grupimi ndikon rrjedhimisht më tej në shpërndarjen e ngarkesës për gjyqtar, duke marrë në konsideratë edhe ngarkesën aktuale të tyre edhe kompleksitetin apo volumin e punës që përmban dojsa përkatëse.

9. MODELE STANDARTE VENDIMESH - drafte të miratuara me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Rekomandime: të ndërhyet në ligjet procedurale, për të kornizuar çështjen e arsyetimit të kuptueshëm të një vendimi gjyqësor. Duke evituar stërzgjatjen apo karakterin voluminoz të një vendimi gjyqësor, automatikisht reduktohet edhe koha e nevojshme që do të impenjonte shpenzimi i energjive për diçka të tillë.

Në të njëjtën linjë dhe logjikë të modelimit të vendimeve për disa çështje të caktuara, sipas Vendimit nr. 434, datë 22.07.2025 të KLGJ-së, do të sugjerohet të përfshiheshin edhe vendimet për çështjet e natyrës familjare, të marrëdhënieve të punës, të të drejtave të përfitimit të pensionit e të sigurimeve shoqërore, të cilat kategorizohen në çështjet e natyrë prioritare apo për shqyrtim me procedurë të përsheptuar në Gjykatën e Apelit.

Përfshirjen e këtyre vendimeve model për këtë natyrë çështjesh, e konsiderojmë si një nga zgjerimet më logjike dhe të nevojshme të vendimeve model sipas Vendimit nr. 434, datë 22.07.2025 të KLGJ-së, i cili aktualisht mbulon më së shumti çështje civile, tregtare dhe procedurale, por jo në mënyrë të plotë çështjet familjare, të punës dhe të pensioneve.

10. MENAXHIMI I CËSHTJEVE - Sistem menaxhimi çështjesh tërësisht të unifikuar dhe të lehtë në aksesim me mundësi depozitimi digital dhe video

Rekomandime:

- e. Të zhvillohen takime dhe prezantime me aktorët dhe grupet e interesit që janë faktorë në harmonizimin dhe integrimin e një sistemi të unifikuar (përfshirë palë dhe avokatë) për t'u njohur me përmbledhje të projektit aktual, masat e rekomanduara për dixhitalizim dhe efektet e pritshme për efikasitetin;
- f. Të sigurohet publikimi i përmbledhur i çdo veprimi dhe hapi të kryer për qëllime transparence;
- g. Të sigurohet ruajtja e integritetit dhe ndërveprimit midis ICMIS dhe ARKIT në mënyrë që arkivimi të bëhet automatik dhe të ruhet në disa vendndodhje me kopje dixhitale;
- h. Të njoftohet apo sinjalizohen palët në sistemin e integruar ICMIS që dokumentat e dosjes tashmë ruhen të arkivuara.

11. ZGJIDHJA ALTERNATIVE - e detyruar përpara se palët t'i drejtohen gjykatës

Rekomandim:

Së pari: Mendojmë së duhet të shtohet në Kodin e Procedurës Civile parashikimi i cili qartëson kompetencat e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të urdhëruar Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve si përpjekje e pare për palët, përpara se çështja të shqyrtohet nga gjykata, në disa raste të caktuara, si për shembull për çështje të natyrës tregtare midis palëve në një marrëdhënie tregtare afatgjatë (p.sh. *franchising*) e cila është komplekse dhe për të cilën gjykata vlerëson se mund të zgjidhet më mirë dhe me më pak kosto e më shpejt në kohë nëpërmjet zgjidhjes alternative, ose për çështje sensitive familjare të cilat duhet të zgjidhen shpejt me qëllim për të stabilizuar eventualisht marrëdhënien midis palëve.

Së dyti: Gjithashtu, mendojmë se vlen të parashikohet në Kodin e Procedurës Civile edhe rregullimi sipas të cilit orientimi i palëve drejt zgjidhjeve alternative duhet të jetë real, substancial dhe jo thjesht formal në përmbushje të detyrimeve formale të gjykatës. Kështu mund të parashikohet në një propozim për ndryshime ligjore se përpara paraqitjes së padisë, palët që kanë mosmarrëveshje civile, tregtare apo të punës janë të detyruara të provojnë se kanë ndjekur procedurën e ndërmjetësimit ose, sipas rastit, të arbitrazhit, përpara se të drejtohen në gjykatë, duke paraqitur edhe vërtetimin e ndërmjetësit ose të qendrës së ndërmjetësimit për përfundimin e procesit të ndërmjetësimit, ose vërtetimin e refuzimit të

palës tjetër për të marrë pjesë në të. Në mungesë të këtij vërtetimi, gjykata, me vendim të arsyetuar, pezullon shqyrtimin e çështjes dhe i jep palës paditëse një afat 30-ditor për të plotësuar detyrimin.